



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 24.30.1-2013-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË AUTORITETIT
RREGULLATIV TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE
POSTARE PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2013

Prishtinë, Maj 2014

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm, Lage Olofsson, është kreu i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë të pavarur dhe certifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, derisa ndërmarrin forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve të tjera të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Ibrahim Gjylderen, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Valbon Bytyqi i mbështetur nga, Shehrije Shala (Udhëheqëse Ekipi) dhe Veton Misiri.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia	6
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Rekomandimet e vitit paraprak	9
4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli	10
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP	22
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak.....	25

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare për vitin 2013 i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Unë do të doja të falënderoja Kryetarin e Bordit dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë gjithë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2013 u ndërmor në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorit Publik (SNISA) të nxjerra nga INTOSAI. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 05 dhjetor 2013.

Auditimi ynë është fokusuar në:

- Pajtueshmërinë me kornizën e raportimit dhe rreziqet domethënëse për pasqyrat vjetore financiare të theksuara në memon e planifikimit të auditimit;
- Veprimet e ndërmarra ndaj rekomandimeve tona për vitin 2012 dhe atyre të mëhershme; dhe
- Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm të Autoritetit Rrregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (duke përfshirë menaxhimin dhe ekzekutimin e buxhetit).

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2013 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të përgjithshëm. Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm është:

Pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale (ISSAI 200 Opinion i Pamodifikuar).
--

Konkluzioni i përgjithshëm

Bazuar në detajet e paraqitura në secilën pjesë të këtij raporti, konkluzioni ynë i përgjithshëm është se:

Menaxhmenti i Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare ka monitoruar në vazhdimësi adresimin e rekomandimeve të dhëna në vitin 2012 dhe ka bërë progres domethënës në këtë drejtim. Megjithatë, rekomandimet e pa adresuara vazhdojnë të kenë ndikim në fusha të rëndësishme të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Kjo paraqet nevojën për veprime shtesë, deri në adresimin e plotë për të gjitha çështjet e ngritura nga auditimi.

Kontrollet mbi menaxhimin e përgjithshëm të buxhetit janë relativisht të mira. Realizimi i buxhetit ishte në një nivel të arsyeshëm, përveç kategorisë së investimeve kapitale, për të cilën kërkohet një zhvillim i mëtejme i procesit buxhetor. Theks i veçantë duhet t'i vihet zbatimit të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve dhe Programit për Investime Publike ashtu siç është parashikuar.

Megjithatë, kontrollet mbi një serë fushash lidhur me menaxhimin e shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtutjeshëm. Theks i veçante, duhet të vihet shfrytëzimit jo adekuat të automjeteve.

Dobësitë e përmendura me lartë, ndërliken edhe me mos themelimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm, e cila ka paraqitur një zbrastë në sistemin e përgjithshëm të kontrolleve.

Rekomandimet tona kryesore janë si në vijim:

Kryetari i bordit, njëherazi Zyrtari Kryesor Administrativ duhet të siguroj se:

- Është përgatitur një plan veprimi për adresimin e rekomandimeve të ZAP-it, duke i përcaktuar qartë afatet kohore dhe anëtarët e stafit llogaridhënës. Adresimi duhet të behet sipas prioriteteve, me fokus fillestar në fushat e rëndësishme më të madhe;
- Është bërë një analizë dhe vlerësim kritik mbi planifikimin e detajuar të projekteve kapitale duke marr parasysh edhe mundësitë dhe pengesat që mund të dalin gjatë realizimit të tyre;
- Është shqyrtuar mundësia për të rishikuar rregulloren për menaxhimin e automjeteve, duke eliminuar mundësinë për përdorimin e tyre për qëllime private. Kontrolle shtese nevojiten edhe në evidentimin rreth menaxhimit të automjeteve; dhe
- Është shqyrtuar mundësia që brenda një periudhe të caktuar kohore të themelohet Njësia e Auditimit të Brendshëm. Deri në themelimin e kësaj njësie, të shfrytëzohen shërbimet e Njesisë së Auditimit të Brendshëm në kuadër të Ministrisë së Financave.

Përgjigja e Menaxhmentit – auditimi 2013

Menaxhmenti është pajtuar me të gjitha të gjeturat tona të auditimit dhe janë zotuar se do ti adresojnë rekomandimet tona.

1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) të përgatisë pasqyrat vjetore financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshinë ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinionëve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar kontrollet menaxheriale, për të përcaktuar shkallen deri ku mund të mbështetemi në to, për përcaktimin e testimit të hollësishëm, i cili është i nevojshëm për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive, për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP) dhe fokusin e auditimit tonë të pajtueshmërisë.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i mënyrës se si Menaxhmenti i ka adresuar rekomandimet e bëra në vitin 2012 mund të gjendet në Shtojcën II.

Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurat vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar. Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët do të raportohen veçmas stafit të financave.

2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Rishikimi ynë i PVF-ve merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Disa deklaratat kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

ARKEP, ka arritur të dorëzoj me kohë të gjitha raportet të cilat kërkohen me kornizën e aplikueshme ligjore. PVF-të kanë përmbushur të gjitha kërkesat e SNKSP "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Parasë së Gatshme" dhe Rregullës Financiare nr. 03/2013. Ato ofronin informata të sakta dhe të plota në lidhje me ngjarjet dhe transaksionet e prezantuara.

2.1 Opinioni i Auditimit

Opinion i pamodifikuar¹

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare *prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale **(ISSAI 200 Opinion i Pamodifikuar)**.

¹ Termi „opinion i pamodifikuar” është ekuivalent me termin „opinion i pakualifikuar” i përdorur në versionin paraprak të Raportit Vjetor. Terminologjia e re është në pajtim me standardet të reja të INTOSAI-t (ISSAI 200). Për më shumë informacion referohu në shtojcën I.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për raportim në PVF

Përshkrimi

PVF-të duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF - Nr 03/2013 për pasqyrat financiare vjetore të organizatave buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 dhe ndryshim plotësimet e tij; dhe
- Kërkesat e rregullores 01/2013/MF - Shpenzimi i parave publike dhe rregullores MF-nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare të organizatave buxhetore.

Ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me këto kërkesa.

2.3 Pajtueshmëria me kërkesat e tjera për raportim të jashtëm

Përshkrimi

Përveç hartimit të PVF-ve, nga ARKEP kërkohet të adresojë obligimet për raportim të jashtëm si në vijim:

- Kërkesat Buxhetore;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore me kohë;
- Raportet operative vjetore (të performancës);
- Draft Plani dhe plani përfundimtar i prokurimit me kohë;
- Raportet mbi borxhet e dorëzuara në MF;
- Raportet mbi kontrollet e brendshme, duke përfshirë raportin e vetëvlerësimit;
- Planin e veprimit për implementimin e rekomandimeve; dhe
- Inventarizimin dhe regjistrimin e pasurive në pronësi të ARKEP-it.

Te gjitha kërkesat për raportim të jashtëm janë përmbushur me kohë nga ARKEP. Përgjithësisht nga kjo bënë plani i veprimit për implementimin e rekomandimeve i cili nuk është përgatitur me kohë. Për më tepër rreth kësaj sqarohet të Kapitulli 3 Rekomandimet e vitit paraprak.

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Menaxhmenti i ARKEP-it bërë progres domethënës në adresimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit për vitin 2012. Megjithatë, rekomandimet e pa adresuara ndikojnë në fusha të rëndësishme të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Andaj Menaxhmenti duhet të jetë i gatshëm të marr përgjegjësitë për të gjitha çështjet e ngritura nga auditimi.

Rekomandimet e pa adresuara tregojnë se në fusha të caktuara vazhdojnë të ekzistojnë dobësitë e njëjta, të bartura nga vitet paraprake.

Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e ARKEP-it për vitin 2012, ka rezultuar më shtatë (7) rekomandime kryesore. ARKEP nuk ka përgatitur më kohë një plan veprimi për të siguruar se të gjitha rekomandimet adresohen brenda periudhës së specifikuar. Ky plan është ofruar më datën 25 shtator 2013, më 3 muaj vonesë.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2012, katër (4) rekomandime janë adresuar plotësisht, dy (2) janë adresuar pjesërisht, ndërsa një (1) nuk është adresuar ende.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe se si janë adresuar ato, shih Shtojcën II.

1 - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

E gjetura ARKEP, nuk ka përgatitur më kohë një Plan veprimi për të siguruar se të gjitha rekomandimet adresohen brenda periudhës së specifikuar. Ky plan është ofruar më datën 25 shtator 2013, përkatësisht më 3 muaj vonesë.

Vonesat në marrjen e masave për të adresuar rekomandimet tona kanë rezultuar në dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të brendshme në disa fusha. Kjo kryesisht ka të bëjë më planifikimin dhe realizimin e buxhetit nga kategoria e investimeve kapitale.

Rreziku Përsëritja e rekomandimeve nga viti në vit është tregues se problemet e njëjta po vazhdojnë të përsëriten.

Rekomandimi 1 Kryetari i Bordit duhet të siguroj një plan veprimi për adresimin e rekomandimeve të AP-së, duke i përcaktuar qartë afatet kohore dhe anëtarët e stafit llogaridhënës. Adresimi duhet të behet sipas prioriteteve, me fokus fillestar në fushat e rëndësishme më të madhe.

4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

4.1 Konkluzioni i përgjithshëm

Qasja jonë e auditimit është fokusuar në të kuptuarit dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv dhe rezultate nga këto veprime. Për sisteme individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin operojnë kontrollet aktuale. Ky nivel, për shembull, mund të jetë aktiviteti monitorues i ndërmarrë nga menaxhmenti i lartë apo kontrollet operative të nivelit më ulët. Ne konsiderojmë se kontrollet janë të dizajnuara mirë, janë zbatuar siç është planifikuar dhe funksionojnë në mënyrë efektive. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjave e llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, duke përfshirë rolin e ndërmarrë nga Auditimi i Brendshëm dhe Komitetet e Auditimit.

Kontrollet mbi menaxhimin e përgjithshëm të buxhetit janë relativisht të mira. Realizimi i buxhetit ishte në një nivel të arsyeshëm, përveç për investimet kapitale, për të cilën kërkohet një zhvillim i mëtejme i procesit buxhetor. Theks i veçantë duhet t'i vihet zbatimit të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve dhe PIP ashtu siç është parashikuar.

Megjithatë, kontrollet mbi një serë fushash lidhur me menaxhimin e shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtutjeshëm. Theks i veçante, duhet të vihet shfrytëzimit jo adekuat të automjeteve.

Dobësitë në fushat e përmendura ndërlidhen edhe me mungesën e themelimit të NjAB-së, e cila ka paraqitur një zbrazëti në sistemin e përgjithshëm të kontrolleve.

4.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Përshkrimi

Në kemi shqyrtuar burimin e fondeve buxhetore për ARKEP, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkasuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2013 Realizimi	2012 Realizimi	2011 Realizimi
Burimet e Fondeve:	1,090,188	846,591	682,713	632,279	804,488
Granti i Qeverisë -Buxheti	1,090,188	836,684	682,713	632,279	28,708
Të hyrat vetanake ³					735,676
Donacionet e jashtme		9,907			40,104

Në tabelën 1, shihet se Buxheti final ishte zvogëluar për 243,597€ në raport me buxhetin fillestar.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2013 Realizimi	2012 Realizimi	2011 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	1,090,188	846,591	682,713	632,279	804,488
Pagat dhe Mëditjet	289,888	289,888	289,558	266,487	295,196
Mallrat dhe Shërbimet	387,600	387,600	259,371	251,088	319,193
Shërbimet komunale	12,700	12,700	12,390	11,034	10,332
Investimet Kapitale	400,000	156,403	121,396	103,670	179,826

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

Për investime kapitale, ARKEP ka planifikuar pesë (5) projekte kapitale. Prej tyre dy (2) janë realizuar brenda vitit 2013. Ndërsa, për pamundësinë e realizimit të tri (3) projekteve ARKEP ka njoftuar Ministrinë e Financave brenda afateve të rregullta ligjore.

² Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

³ Një pjesë e faturave të planifikuara dhe të mbledhura për Buxhetin e Kosovës në vitin aktual që është përdorur nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

Arsyetimet e përmbledhura për pamundësinë e realizimit të projekteve kapitale janë si në vijim:

- Projekti “Platforma Softuerike për menaxhimin e bartshmërisë së numrave (Number Portability)”, nuk ka arritur të realizohet si rrjedhojë a pamundësisë për të siguruar kodin shtetëror telefonik të Kosovës gjatë viti 2013;
- Projekti “Zhvillimi i platformës softuerike”, është ndërlidhur me kompletimin e legjislacionit sekondar, i cili nuk është përfunduar gjatë viti 2013; dhe
- Projekti “Zhvillimi i analizës dhe përgatitja për aplikimin e Kosovës pranë ICANN⁴ dhe IANA ⁵për ndarje sigurim të kodit ccTLD⁶ dhe gTLD⁷”, nuk është realizuar për arsye se IANA nuk kishte shpallur Ftesën për Ofertë gjatë vitit 2013.

Mjetet e alokuara për këto projekte janë tërhequr pas vendimit të Ministrit të Financave nr. 1976 të datës 01 tetor 2013 për kursime të mundshme buxhetore. Deklarata për mos realizimin e projekteve kapitale nga ZKF është bërë më datën 07 tetor 2013. Kursimet buxhetore janë bërë te kategoria e investimeve kapitale në vlerën 253,504€ (Diferenca në mes të buxhetit fillestar dhe final në vlerë 243,597€ si dhe donacioni i bartur në vlerë 9,907€).

Ekzekutimi i përgjithshëm i buxhetit për vitin 2013, ishte 682,713€ apo 81% e buxhetit final. Realizimi i ulët i buxhetit vërehet te kategoria e mallrave dhe shërbimeve me 67% dhe te kategoria e investimeve kapitale më 78%.

Realizim i mirë i buxhetit u vërejt tek kategoria e pagave dhe mëditjeve afër 100% dhe tek kategoria e shpenzimeve komunale me 98%.

Tabela 3. Të hyrat e inkasuara për buxhetin e Kosovës - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2013 Realizimi	2012 Realizimi	2011 Realizimi
Të hyrat vetanake	7,000,000	6,100,000	5,524,640	5,749,363	18,043,503
Totali	7,000,000	6,100,000	5,524,640	5,749,363	18,043,503

Për vitin 2013 janë planifikuar të hyra në vlerë 6,100,000€, ndërsa janë grumbulluar 5,524,640€ ose 90.57% në raport me buxhetin final. Këto janë diskutuar më shumë në seksionin 4.2.

⁴ ICANN - Korporata e internetit për caktimin e emrave dhe numrave / Internet Corporation for Assigned Names and Numbers

⁵ IANA - Autoriteti për caktimin e Protokolleve të Internetit/Internet e Assigned Numbers Authority

⁶ ccTLD- Kodi Shtetëror i Internetit / Country Code Top Level Domain

⁷ gTLD - Generic Top Level Domain

Çështja 2 - Realizimi i Buxhetit - Prioritet i lartë

E gjetura ARKEP, me buxhet fillestar, kishte paraparë pesë (5) projekte për investimet kapitale. Prej tyre dy (2) projekte janë realizuar brenda vitit 2013. Nëse e krahasojmë shpenzimin e buxhetit me buxhetin fillestar në këtë kategori shohim se 30% ishte shpenzuar.

Gjithashtu, shfrytëzimi i buxhetit për investime kapitale nuk ishte bërë në pajtim me planin kohor të rrjedhës së parasë. Në muajin dhjetor ishin shpenzuar 81,496€ ose mbi 52% e buxhetit final për këtë kategori.

Rreziku Planifikimi joadekuat si dhe vonesat në ekzekutimin e buxhetit shpjen në mos implementimin e projekteve esenciale për arritjen e objektivave strategjike. Po ashtu, fluksi i madh i shpenzimeve kapitale që mbetet të realizohet në fund të vitit rrezikon që pagesat t'i shmangen kontrolleve të duhura të procesit të certifikimit.

Rekomandimi 2 Kryetari i Bordit duhet të sigurojë se është bërë një analizë dhe vlerësim kritik mbi planifikimin e detajuar të projekteve kapitale duke marr parasysh edhe mundësitë dhe pengesat që mund të dalin gjatë realizimit të tyre.

4.3 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetanake)

Përshkrimi

Të hyrat e grumbulluara nga ARKEP në vitin 2013 ishin në total 5,524,640€ ose 90.57% në raport me planifikimin e tyre. Për të arritur në një përfundim lidhur me menaxhimin e të hyrave, ne kemi përzgjedhur 58 mostra.

Mostrat e përzgjedhura përfshijnë:

- Akordimi dhe dhënien në shfrytëzim të së drejtës për resurse të spektrit frekuencor;
- Akordimin dhe dhënien në shfrytëzim të resurseve të numeracionit;
- Licencimet të Radio Amatoreve;
- Mbikëqyrja e Tregut;
- Shqiptimin e masave sanksionuese/ndëshkimeve; dhe
- Nyja shkëmbyese e Internetit (Qendra KOSIX).

Bazuar në këtë vijmë në përfundim se të hyrat janë menaxhuar në pajtueshmëri të plotë me Legjislacionin aktual.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.4 Shpenzimet

4.4.1 Prokurimi

Përshkrimi

Ne kemi rishikuar procesin e blerjeve përmes prokurimit për të vlerësuar nëse ARKEP, ka zbatuar procedurat dhe i është përmbajtur dispozitave të ligjit të prokurimit publik (LPP). Ekzaminimet tona audituese kanë përfshirë tërë procesin e prokurimit, duke filluar nga inicimi i aktiviteteve të prokurimit e deri në menaxhimin dhe realizimin e kontratave.

Bazuar në këtë ne identifikuam çështjet si në vijim:

Çështja 3 - Lidhja e kontratës në mungesë të dokumenteve të kërkuara -Prioritet i mesëm

E gjetura Në lëndën “Furnizim me pajisje te teknologjisë informative”, sipas dosjes se tenderit te kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, është kërkuar dëshmia mbi pagesën e rregullt të energjisë elektrike (kjo dëshmi është kërkuar vetëm për fituesin e kontratës).

Fillimisht në ofertën e fituesit mungonte dëshmia për pagesën e energjisë elektrike. Përkundër kësaj autoriteti kontraktues e kishte shpërblyer me kontratë. Vlera e kontratës ishte 9,939€.

Autoriteti Kontraktues e ka plotësuar më pas këtë dosje duke ofruar kështu dëshminë mbi pagesën e energjisë elektrike.

Rreziku Mungesa e dokumenteve në dosjet e tenderit shpie deri të rreziku se vlerësimi i ofertave është bërë pavarësisht mungesës së dokumenteve të caktuara. Në anën tjetër ekziston rreziku që dosjet e tenderit të plotësohen pas identifikimit të parregullsive nga auditimi i jashtëm.

Rekomandimi 3 Kryetari i Bordit duhet të siguroj kontrole shtesë në proceset e prokurimit, përkatësisht në dokumentimin dhe ruajtjen e të dhënave të prokurimit. Dokumentet shtesë që kërkohen prej fituesit të kontratës duhet t'i bashkëngjiten dosjes se prokurimit.

4 - Nxjerrja e urdhërblërjes pas pranimit të Faturës- Prioritet i mesëm

E gjetura Në gjashtë (6) kontrata të testuar vërejtëm se urdhërblërja është nxjerrë pas pranimit të faturës. Prej tyre dy (2) kontrata vlerat e të cilave janë me të larta janë prezantuar si në vijim:

- Te lënda *“Furnizim me dy vetura”*, faturimi është bërë para urdhërblërjes. Fatura në vlerë 39,900€ ishte pranuar me datë 03 qershor 2013, ndërsa urdhërblërja nga menaxheri i prokurimit është bërë me 05 qershor 2013; dhe
- Te lënda *“Krijimi i Platformës për Kontrollin e Kualitetit (QoS) të Telefonisë së Zërit”* faturimi është bërë para urdhërblërjes. Fatura në vlerë 81,485€ ishte pranuar me datë 17 dhjetor 2013, ndërsa urdhërblërja nga menaxheri i prokurimit është nxjerrë bërë me 31 dhjetor 2013;

Ndërsa në katër (4) kontrata të tjera që kanë të bëjnë në kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve, për të cilat fatura është pranuar para urdhërblërjes janë: *“Furnizim me material elektrik për lidhjen e gjeneratorit”* në vlerë 826€; *“Çmontimi dhe bartja e Serverëve dhe pajisjeve të sigurisë”* në vlerë 2,915€; *“Rialokimi/Zhvendosja e orendive, produkteve dhe materialeve tjera përcjellëse”* në vlerë 3,850€; *“Përkthimi dhe lektorimi i materialeve sipas kërkesave të ARKEP-it”* në dy pagesa në vlerë 118€ (0.0026€ për njësi).

Rreziku Rastet e prezantuara me lartë tregojnë se ARKEP, nuk kishte kontrolle funksionale në procesin e ekzekutimit të pagesave. Pranimi i mallrave dhe shërbimeve para urdhërblërjes, mund të shkaktoj vështirësi në ekzekutimin e pagesave.

Rekomandimi 4 Kryetari i Bordit duhet të sigurohet që të forcoj kontrollet në procesin e ekzekutimit të pagesave duke siguruar procesimin e tyre në pajtim me hapat e përcaktuar me LMFPP dhe me rregulla të thesarit.

Çështja 5 - Mungesa e evidencave për shpenzimet e karburanteve- Prioriteti i mesëm

- E gjetura** ARKEP nuk kishte evidenca analitike për shpenzimet e karburanteve. Në mungesë të kësaj ata shfrytëzojnë të dhënat e ofruara nga OE, i cili faturon në fund të muajit, bazuar në fletëngarkesat e lëshuara.
- Rreziku** Menaxhmenti i ARKEP nuk zbaton kontrole të mjaftueshme për shfrytëzimin e karburanteve për automjete zyrtare. Në mungesë të evidencave të mjaftueshme ekziston rreziku i mbi pagesës për shpenzimet e tilla.
- Rekomandimi 5** Kryetari i Bordit duhet të siguroj se janë ndërmarrë veprimet e duhura për të përmirësuar kontrollet mbi menaxhimin dhe shfrytëzimin e karburanteve. Lidhur me këtë duhet të mbahen evidenca bazuar në dokumentet burimore, dhe bazuar në to të behën pagesat e shpenzimeve.

6 - Kalkulimi i çmimit mesatar sigurohet nga Operatori- Prioritet i mesëm

- E gjetura** Sipas kushteve të kontratës, "Furnizim me naftë për automjete dhe gjenerator", OE obligohet që në fund të çdo muaji me rastin e furnizimit, se bashku me faturën t'i dorëzoj autoritetit kontraktues kalkulimin e çmimit të bazuar në berëzën ndërkombëtare, identik me kalkulimet qeveritare.
- Menaxhmenti i ARKEP-it kishte ekzekutuar pagesat duke u mbështetur në çmimoren e ofruar nga OE, duke mos marrë parasysh llogaritjen e ndryshimit të berëzës nga autoritetet publike (Zyra e Kryeministrit ose ndonjë organ tjetër në sektorin publik).
- Rreziku** Mos sigurimi i çmimit mesatar të naftës, ka vënë në rrezik institucionin që të paguaj çmime më të larta për karburante, në raport me çmimin e kontraktuar.
- Rekomandimi 6** Kryetari i Bordit duhet të shqyrtoj mundësinë për të siguruar çmimin mesatar të berëzës nga burime të palëve të treta, qoftë nga Zyra e Kryeministrit ose ndonjë institucion tjetër që ka të njëjtat informata.

4.4.3 Shpenzimet jo përmes prokurimit

Përshkrimi

Në kategorinë e shpenzimeve tjera për të cilat nuk nevojitet të zhvillohen procedura të prokurimit, ne kemi testuar disa pagesa për mallra dhe shërbime, përfshirë edhe pagesat për udhëtime jashtë vendit. Bazuar në këtë ne identifikuam çështjen si në vijim:

Çështja 7 - Mungesë e protokollimit të faturave - Prioriteti i mesëm

- E gjetura** Sipas rregullës financiare 01/2013 - Shpenzimi i parave publike, te neni 24, pranimi dhe pagesat e faturave, kërkohet që faturat të protokollohen dhe të evidentohen në librin e faturave. Në këtë aspekt ARKEP nuk kishte kontrolle të duhura, përkatësisht ata kishin mbajtur një libër për evidencat e faturave, mirëpo ato nuk ishin protokolluar.
- Rreziku** Mos protokollimi i faturave shpie në rrezikun për humbjen e faturave, ose dyfishimin e tyre. Kjo do të krijonte paqartësi në menaxhimin dhe raportimin e obligimeve.
- Rekomandimi 7** Kryetari i Bordit duhet të siguroj se në harmoni me rregullën financiare mbi shpenzimin e parave publike të protokolloj secilën faturë të pranuar.

4.4.4 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagave (payrollit). ARKEP ka kontrolle adekuate në përgatitjen e listave të pagave, verifikimin e ndryshimeve të mundshme si dhe në harmonizimet me Departamentin e Shërbimit të Administrimit Civil (DASHC) si dhe Ministrisë së Financave (MF).

Buxheti për paga dhe mëditje për vitin 2013 ishte 289,888€. Nga këto janë shpenzuar 289,557€, përkatësisht afro 100% të buxhetit. Numri i pozitave të aprovuara për vitin 2013 është 37, ndërsa numri aktual i punëtorëve në fund të vitit sipas listës së pagave ishte 36.

Ne testuam 14 mostra të kësaj fushe. Testimet kanë përfshirë zhvillimin e procesit të rekrutimit, pajtueshmërinë e pagesave të pagave në raport me kontratat e punës, përfshirë edhe bazën e koeficienteve, të punësuarit që kanë lëndë vendin e punës, të pensionuarit, vlerësimin vjetor të performancës, dhe mirëmbajtjen e dosjeve të personelit.

Çështja 8 - Mos vlerësimi i performancës së stafit për vitin 2013 - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Vlerësimi i rezultateve të punës nënkupton procesin e vlerësimit të realizimit të objektivave të punës nga çdo nëpunës civil dhe vlerësimin e aftësive të nëpunësit civil, që kanë shërbyer në arritjen e objektivave.⁸ Në gjashtë (6) dosje të testuara ne nuk kemi hasur në ndonjë dëshmi se ARKEP, ka bërë vlerësimin vjetor të performancës për të punësuarit e saj.
- Menaxhmenti, në fillim të vitit 2014 ka filluar për të bërë vlerësimin e performancës për tërë stafin. Megjithatë, kjo çështje kërkon një vlerësim në të ardhmen.
- Rreziku** Moskryerja e vlerësimit të punës për të punësuarit dhe kontrolli jo i mirë, mund të ketë efekt negativ në performancën e mëtutjeshme të punëtorëve në organizatë. Njëherit, kjo pamundëson identifikimin e fushave me mangësi për përmirësim dhe zhvillimin e tyre në mënyrë më efektive.
- Rekomandimi 8** Kryetari i Bordit duhet të sigurojë, se nëpërmjet zyrtarëve përgjegjës të njëjësive përkatëse, janë kryer më kohë të gjitha vlerësimet vjetore të punës për të gjithë punësuarit. Ky proces do të mundësojë identifikimin e fushave me mangësi me qëllim të zhvillimit të mëtutjeshëm.

4.5 Pasuritë dhe obligimet

4.5.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrimi

Sipas regjistrit kontabël (SIMFK), vlera neto e pasurive të ARKEP-it është 1,243,000€, ndërsa pasuria jo-kapitale me vlerë nën 1000€ është 31,000€.

Ne kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit dhe mënyra e mbajtjes së evidencës është në pajtueshmëri me kërkesat e Rregullores MF-nr. 02/2013, për menaxhimin e pasurisë jo financiare të organizatave buxhetore. Gjithashtu, ne kemi verifikuar nëse ekziston fizikisht pasuria e evidentuar në regjistrat e pasurisë.

Mostra jonë ka përfshirë pasuritë e blera gjatë vitit 2013 (furnizimin e dy veturave zyrtare në vlerë prej 39,900 si dhe Softuerin për Kontrollin e Kualitetit (QoS) të Telefonisë së Zërit në

⁸ Rregullore Nr.19/1012 për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil

vlerë prej 81,496€). Më tutje, në kuadër të testimit substancial, ne përzgjedhëm një mostër në vlerë 2,256,568.46€ (kosto historike) për të testuar ekzistencën e tyre.

Me këtë rast, nuk është hasur në ndonjë parregullsi për tu raportuar. Zyrtari i pasurive ka bërë azhurnimin e vazhdueshëm të pasurisë, andaj posedon një regjistër të plotë dhe të saktë lidhur me pasurinë që disponon. Në fund të vitit ishte kryer edhe inventarizimi i pasurisë.

Megjithëse, ARKEP nuk kishte menaxhim të mirë të shpenzimeve për përdorimin e automjeteve. Kjo është prezantuar në vijim.

Çështja 9 - Evidenca jo të plota lidhur me menaxhimin e automjeteve - Prioritet i lartë

E gjetura ARKEP, nuk ka mbajtur evidenca të plota lidhur me menaxhimin e automjeteve. Ata nuk kishin përgatitur raporte mujore për kilometrat e kaluara për secilin automjet. Përpos kësaj ne vërejtëm se mungonin edhe procedurat mbi shfrytëzimin e automjeteve (kërkesat e aprovuara për udhëtime zyrtare nga udhëheqësit e sektorëve përkatës).

Në fund të muajit dhjetor 2013, ARKEP ka nxjerrë një rregullore të brendshme për menaxhimin e automjeteve zyrtare. Disa nene të kësaj rregullore nuk janë në pajtim me kërkesat për menaxhimin e pasurisë publike. Neni 3.5 dhe Neni 6 mundësojnë përdorimin e automjeteve jashtë detyrave zyrtare, përkatësisht për qëllime private ndërsa Neni 7 mundëson përdorimin e automjeteve për transportimin e personave që nuk janë zyrtar të autoritetit.

Rreziku Mos respektimi i procedurave për menaxhimin dhe përdorimin e automjeteve rrezikon në shfrytëzimin jo racional të tyre. Kjo mund të pasojë më kosto shtesë të karburanteve si dhe shpenzimeve tjera rreth riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve.

Rekomandimi 9 Kryetari i Bordit duhet të shqyrtoj mundësinë të rishikoj edhe njëherë rregulloren për menaxhimin e automjeteve, duke eliminuar mundësinë për përdorimin e tyre për qëllime private. Kontrollë shtese nevojiten edhe në evidentimin rreth menaxhimit të automjeteve.

4.5.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve

Përshkrimi

Të hyrat e pa mbledhura dhe të prezantuara në PVF ishin 199,678€. Prej tyre 78,328€ janë fatura të papaguara nga vitet paraprake, ndërsa 121,350€ janë fatura të papaguara të periudhës aktuale.

ARKEP, bazuar në kornizën ligjore, ka përdorur të gjitha procedurat e mundshme për të inkasuar të arkëtueshmet e tyre. Në raste të mos ekzekutimit të urdhrave dhe dënimeve nga shkelësit/kundërvajtësit, ARKEP, ka proceduar inicimin e procedurave gjyqësore pranë gjykatës kompetente.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.6 Trajtimi i borxheve

Përshkrimi

ARKEP, në vitin 2013 ka raportuar obligime të papaguara në pajtim me kërkesat e rregullores financiare nr. 02/2013/MF për raportimin e obligimeve të papaguara të organizatave buxhetore dhe në pajtim me Rregulloren MF - Nr 03/2013 për PVF-të e organizatave buxhetore.

Pasqyra e obligimeve të papaguara të ARKEP-it ndaj furnitorëve në fund të vitit 2013 ishte në shumë prej 6,329€. Të gjitha obligimet e mbetura janë ndaj faturave të muajit dhjetor 2013 të cilat kanë arritur pas mbylljes së afatit ligjor për pagesë.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.7 Sistemi i auditimit të brendshëm

Përshkrimi

ARKEP, edhe gjatë vitit 2013, nuk kishte arritur të sigurojë shërbimet e auditimit të brendshëm. Në raportin e auditimit të PVF-ve të ARKEP-it, për vitin 2012, ne kemi rekomanduar që të merren masat e nevojshme për të themeluar Njësine e Auditimit të Brendshëm (NJAB). Ky rekomandim nuk është adresuar nga Menaxhmenti, si pasojë e mungesës së buxhetit dhe pozitave të aprovuara.

Si pasojë e kësaj, Menaxhmenti nuk ka një pasqyrë të qartë mbi gjendjen dhe efektivitetin e kontrolleve.

Çështja 10 - Themelimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm -Prioritet i lartë

E gjetura Bazuar në udhëzimin administrativ nr. 23/2009, ARKEP i plotëson kriteret për të themeluar Njësine e Auditimit të Brendshëm (NJAB). Mirëpo edhe përpos rekomandimit tonë të dhënë në vitin e kaluar, ARKEP, ende nuk kishte arritur të themelojë këtë Njësi. Po ashtu gjatë vitit 2013, ajo nuk kishte shfrytëzuar shërbimet e NJAB në kuadër të Ministrisë së Financave (MF) apo shërbimet e auditimit në bashkëpunim me ndonjë subjekt tjetër.

ARKEP, përmes kërkesave buxhetore në vazhdimësi ka kërkuar nga institucionet relevante (Ministria e Financave dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa) aprovimin e pozitës së Auditorit të Brendshëm, mirëpo edhe përkundër përpjekjeve, kjo pozitë nuk është aprovuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa.

Rreziku Mungesa e themelimit të NJAB-së paraqet një zbrazëti në sistemin e përgjithshëm të kontrolleve.

Rekomandimi 10 Kryetari i Bordit duhet të vazhdojë përpjekjet deri në themelimin e NJAB-së. Deri në themelimin e kësaj njësie, shërbimet e auditimit të brendshëm duhet të sigurohen në një mënyrë tjetër.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornizë për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk përhapen në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare mund të jenë materiale por nuk përhapen.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe përhapen në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare mund të jenë edhe materiale edhe të përhapen. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 170519 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për

Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionin e auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
2.2. Cilësia dhe saktësia e informatave të prezantuara në PVF	Menaxhmenti duhet të sigurojë që plani i prodhimit për llogaritë 2013 përfshinë rishikimin menaxherial të draft llogarisë.	Po		
3. Rekomandimet e vitit paraprak	Menaxhmenti duhet të sigurojë që plani i veprimit për adresimin e rekomandimeve tona është rishikuar së bashku me pjesëmarrësit në zingjirin llogaridhënës me qëllim të përcaktimit të veprimeve korigjuese.		Janë ndërmarr veprime në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak, mirëpo ende disa rekomandime nuk janë adresuar.	
4.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Në bashkëpunim me akterët e tjerë, të përcaktoj dhe harmonizoj prioritetet për realizim të projekteve kapitale për të cilat paraprakishtë është konfirmuar mbështetje dhe të cilat kanë mundësi më të madhe të implementohen.			Ky rekomandim edhe me tutje nuk është adresuar. ARKEP, këtë e arsyeton me rëndësinë e projekteve të cilat duhet të planifikohen në vazhdimësi deri në realizimin e tyre.

4.5.1 Prokurimi	Menaxheri i prokurimit duhet të siguroj që zyrtaret e caktuar në komisionet e vlerësimit kanë njohurit e duhura. Me tutje, menaxheri i prokurimit përmes monitorimit duhet të siguroj që ekzistojnë dëshmitë të cilat mbështesin vlerësimet e ofertave nga komisioni i vlerësimit.	Po		
4.5.1 Prokurimi	Të bëhet regjistrimi i shpenzimeve në kode ekonomike duke u bazuar në planin kontabël qeveritar.	Po		
4.6 Pasuritë	Në koordinim më departamentin e thesarit ka shqyrtuar alternativat e duhura për të siguruar vlerësimin e pasurive të cilat tashme e kanë vlerën neto zero, por që edhe me tutje janë në përdorim dhe kanë një vlerë tregu.	Po		
5. Sistemi i auditimit të brendshëm	Te vazhdohet me adresimin e çështjes se themelimit të NJAB-së tek autoritetet përkatëse në Kuvend për të siguruar që aktivitetet e ARKEP-it vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme.		ARKEP, përmes kërkesave buxhetore në vazhdimësi ka kërkuar nga institucionet relevante aprovimin pozitiv të Auditorit të Brendshëm por deri me tani kjo pozitë nuk është aprovuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa.	